

Garë ndërkombëtare KENGUR 17.03.2016

Klasa e 2 dhe 3 -Kategoria PreEcolier

Koha në disponim është 1h e 15 min.

Për përgjigje jo të saktë të pyetjes minusohet një e katërta e numrit të pikëve me të cilat vlerësohet kjo pyetje. Për të shmangur rezultat të përgjithshëm negativ në fund shtohen 24 pikë, kështu që sasia maksimale e pikëve të fituara është 120. Gjatë punës nuk lejohen kalkulatorët.

Cdo detyrë me numër rendor nga 1 deri 8 vlerësohet me 3 pikë


1. Cila shkronjë në tabelë nuk përmbahet tek fjala „KOALA“?

(A) R (B) L (C) K (D) N (E) O



2. Sa litarë ka në vizatimin djathtas ?

(A) 2 (B) 3 (C) 4 (D) 5 (E) 6



3. Miri ndërtoi shtëpi me shkrepse si në vizatimin djathtas. Sa shkrepse përdori Miri për ta ndërtuar?

(A) 19 (B) 18 (C) 17 (D) 15 (E) 13




4. Në një shpellë ndodheshin vetëm dy kuaj deti, një kandil deti dhe tre breshka. Më vonë, atyre iu bashkuan edhe pesë kuaj deti, tre kandila deti dhe katër breshka. Sa kafshë gjithsej kishte në shpellë?

(A) 6 (B) 9 (C) 12 (D) 15 (E) 18

5. Në vizatimin djathtas është treguar një labirint. Deri në cilën pikë mund të arrijmë nëse nisemi nga pika O?

(A) A (B) B (C) C (D) D (E) E




6. Dhjetë shokë erdhën për ditëlindjen e Mirit. Prej tyre gjashtë ishin vajza. Sa djem kishte në ditëlindje?

(A) 4 (B) 5 (C) 6 (D) 7 (E) 8

7. Miri shpërndau fletëudhëzime për riciklim të mbeturinave të shtëpive në rrugicës së tij me numra nga 25 deri 57. Sa shtëpi morën fletëudhëzime?


- (A) 31 (B) 32 (C) 33 (D) 34 (E) 35

8. Cila figurë është e ndërtuar me 10 kube?




Cdo detyrë me numër rendor nga 9 deri 16 vlerësohet me 4 pikë

9. Mira rendit topa të vegjël në kuti në mënyrën e treguar në vizatimin e mëposhtëm. Si do të jetë renditja e topave në kutinë e shënuar me pikëpyetje?



10. Pula Agata bën vezë të bardha dhe të verdha. Meri vendosi gjashtë vezë në kutinë e treguar në vizatimin poshtë majtas. Dy vezë të verdha nuk lejohet të preken me njëra - tjetrën. Sa vezë të verdha më së shumti mund të vendosë Meri në kuti?



- (A) 1 (B) 2 (C) 3 (D) 4 (E) 5



11. Kanguri Kanga është i vjetër 1 vit e 3 muaj. Pas sa muajsh Kanga do të jetë i vjetër 2 vjeç?

- (A) 3 (B) 5 (C) 7 (D) 8 (E) 9


12. Në oborrin e gjyshe Norës ka pula dhe një mace. Të gjitha së bashku kanë 20 këmbë. Sa pula ka në oborrin e gjyshe Norës ?

- (A) 11 (B) 9 (C) 8 (D) 6 (E) 4

13. Në shtëpinë e Meritës, çdo dhomë është e lidhur me dhomën fqinje me derë (shiko vizatimin djathtas).

Cili është numri më i vogël i dyerve nëpër të cilat duhet të kalojë Meritës që të shkojë nga dhoma A në dhomën B?

(A) 3 (B) 4 (C) 5 (D) 6 (E) 7




14. Në një ndërtesë ka dymbëdhjetë dhoma dhe çdo dhomë ka dy dritare dhe një llambë elektrike. Natën e kaluar, drita shihej nga 18 dritare. Në sa dhoma ishin fikur dritat?

(A) 2 (B) 3 (C) 4 (D) 5 (E) 6

15. Mira lëviz në rrugën e treguar në vizatim dhe i lexon vetëm shkronjat që gjenden nga ana e saj e djathtë. Nëse Mira lëviz nga vendi 1 drejt vendit 2, cilën fjalë do ta fitojë?

(A) KNAO (B) KNGO (C) KNR
(D) AGRO (E) KAO




16. Shuma e viteve të Mirit dhe Mirës është 12. Sa do të jetë shuma e viteve të tyre pas 4 vjetësh?


(A) 16 (B) 17 (C) 18 (D) 19 (E) 20

Çdo detyrë me numër rendor nga 17 deri 24 vlerësohet me 5 pikë

17. Cila prej figurave të mëposhtme nuk mund të formohet duke shfrytëzuar vetëm figura nga forma e treguar në vizatimin djathtas ?




18. Cilën prej figurave të vogla të dhëna duhet ta vendosim në mesin e figurës së madhe kështu që vijat me ngjyrë të njëjtë të preken?



19. Mira përdori gjashtë katrorë të vegjël të barabartë që ta formojë figurën e treguar në vizatimin djathtas. Cili është numri më i vogël i katrorëve të barabartë të vegjël të cilët Mirës duhet t'ja shtojë figurës së saj, që të formojë katror më të madh?

(A) 6 (B) 8 (C) 9 (D) 10 (E) 12








20. Pesë zogj rrinë në tel si në vizatimin djathtas. Disa prej tyre shohin majtas, ndërsa disa djathtas. Çdo zog i fishkëlleu nga një herë çdo zogu që e shikonte. Për shembull, zogu i tretë fishkëlleu dy herë. Sa herë fishkëllyen të gjithë zogjtë së bashku?



(A) 6 (B) 8 (C) 9 (D) 10 (E) 12

21. Cila figurë mund të formohet duke përdorur disa prej figurave të treguara në vizatimin djathtas ?





22. Në vizatim ka pesë nuselale. Disa prej tyre rrinë në lule dhe kjo sipas rregullës së mëposhtme: ndryshimi midis numrit të pikave të flatrave të tyre e jep numrin e gjetheve të lules, ndërsa shuma e pikave të flatrave të tyre e jep numrin e petaleve të lules.



Në cilën prej luleve të mëposhtme nuk ka nuselale?



23. Në secilën prej gjashtë faqeve të kubit ka një prej simboleve : ♣, ♦, ♥, ♠, ■ dhe O. Në çdo faqe ka simbol të ndryshëm. Në vizatim është dhënë kubi në dy pozicione të ndryshme. Cili simbol është përballë simbolit ■?



(A) O (B) ♦ (C) ♥ (D) ♠ (E) ♣

24. Numrat 1, 5, 8, 9, 10, 12 dhe 15 janë shpërndarë në grupe prej një ose më shumë numra. Shumat e numrave në secilën prej grupeve janë të barabarta. Në sa grupe më së shumti mund të shpërndahen këto numra?

(A) 2 (B) 3 (C) 4 (D) 5 (E) 6